

## **Akt Thmelimi**

### **I shoqërisë tregtare "MAKËRZA" sh.p.k**

Sot më 20.06.2022, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512, datë 10.08.1991 " Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës privatë, nismës së lirë dhe të veprimtarisë privatë dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndren Komberare të Regjistrimit" i perditësuar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tij të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi ne ortakët:

1- **Arjonel Lame** i biri i Adil Lame dhe Diana Lame, i dtl. 08.01.1984, lindur në Tiranë e banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftim nr. I40108042H / 035192119,

2- **Olta Lame** i bija e Fahri Heqimi dhe Adriana Heqimi e dtl. 23.05.1984, lindur në Shkodër e banuese në Tiranë, shtetase shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftim nr. I45523066M / 032463215.

Të krijojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"MAKËRZA" sh.p.k** me akt themelimi si vijon:

### **Neni 1**

#### **Formulimi**

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur **"MAKËRZA" sh.p.k**. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të këtë sëlinë dega . Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

### **Neni 2**

#### **Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë **ERSEKË, QYTEZË, Rr. Qyteza, nr. 4, godinë private 1kt, Zona Kadastrale 3/28, nr. pasurie 119.**

Shoqëria mund të ndryshojë sëlinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakut të vetëm.

### **Neni 3**

#### **Objektivi i veprimtarisë**

Objekti i shoqërisë do të jetë:

Në fushën e tregëtisë, import-eksport me shumicë dhe pakicë, tregëtim të mallrave industriale, ushqimore, blektorale e bujqësore, prodhim, grumbullim, ruajtje dhe tregëtim fruta-perime.

Objekti i vepimtarisë mund të shtohet apo ndryshohet me Vendim të Asamblesë së

ortakëve të shoqërisë.

#### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të papërcaktuar. Ajo mund shpërbëhet në cdo kohë dhe për çfardo lloj shkak sipas legjislacionit të RSH dhe vendimëmarrjes së ortakëve.

#### **Neni 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 100.000 Lekë, kapital i konfirmuar që në ditën e regjistrimit të shoqërisë. Kapitali i shoqërisë prej 100.000 Lekë është i ndarë në 100 kuota me nga 1.000 lekë secila. Ky kapital themeltar i shoqërisë, është i zotëruar me këtë pjesmarrje;

1-Olta Lame është zotëruar i 50% (pesëdhejetë përqind të kuotave) e barabartë me 50 000 lekë ose e barabartë me 1 kuote.

2- Arjonel Lame është zotëruar i 50% (pesëdhejetë përqind të kuotave) e barabartë me 50 000 lekë ose e barabartë me 1 kuote.

Kapitali i shoqërisë në varësi të rritjes së aktivitetit dhe fitimeve të shoqërisë mund të rritet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

#### **Neni 6**

##### **Drejtimi i Shoqërisë**

Shoqëria do të drejtohet nga administratorja dhe perfaqësuesja ligjore Znj. Florinda Kurti me nr personal I65803101I. Ajo është perfaqësuesja e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Cdo kontratë do të kryhet prej saj dhe në rast mungesë nga perfaqësues i pajisur me prokurë të poscme .

#### **Neni 7**


Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

#### **Neni 8**

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, financier, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortak.

#### **Neni 9**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar.



### **Neni 10**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj .

### **Neni 11**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjom shoqëri.


### **Neni 12**

Akti e themelimit u perpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **"MAKËRZA" sh.p.k**

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë .

### **ORTAKËT E SHOQËRISË "MAKËRZA" sh.p.k**

**Arjonel LAME**

Handwritten signature of Arjonel Lame in blue ink, consisting of a cursive script that reads "Arjonel Lame" with a large flourish at the bottom.

**Olta LAME**

Handwritten signature of Olta Lame in blue ink, consisting of a cursive script that reads "Olta Lame" with a vertical flourish on the right side.